



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 76, 77 dhe 78 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 8 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë - Hani i Elezit, Sektori C2C dhe C3, Zonat kadastrale: Kaçanik i Vjetër, Koxhaj, Soponicë, Doganaj, Rekë, Nikaj, Biqec, Kovaçec, Bob, Gajre, Kaçanik, Gjurgjedell të Komunës së Kaçanikut, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 13/2011 për Zbatimin e Metodave dhe Kriteretive Teknike të Vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: Pikat kufitare Bërnjak, Zona kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok dhe Merdar, Zona kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara në pajtim me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi dhe krijimi i detyrueshëm i servitutit për interes publik për pronat e paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Linjës së dyfishtë 110kV Nën Stacioni Peja 3 dhe Peja 1 dhe Rehabilitimi i linjës ekzistuese 110 kV Nën Stacioni Peja 2 dhe Nënstacioni Deçan, Zonat kadastrale: Ozrim, Vitomicë, Treboviq, Pejë, Komuna Pejë dhe Zonat kadastrale: Bellopojë, Veriq, Llukavc i Thatë, Gjurakovc, Prekallë, Dobrushë, Kashicë dhe Bajicë, Komuna Istog, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave, të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilëndo pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 24,000.00 (njëzetekatërmijë) euro për festimin e 23 Prillit, Ditës së Komunitetit Turk në Kosovë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Zyrës për çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, Kodi buxhetor 15600, Kategoria e Subvencioneve, dhe barten në "Shoqata Unioni Rinor të Kosovës" Numri i llogarisë: 17-05-0016000781.61 NLB Prishtina.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, nr. 04/L-165, nr.04/L-194 dhe nr. 05/L-063, dhe të nenit 13 të Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen 25% të mjeteve financiare në vlerë prej 159,480.00 (njëqind e pesëdhjetenëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro nga Raporti nr. 765 datë 15.02.2016 i Komisionit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vlerësimin e dëmeve në komuna nga vërshimet në bujqësi gjatë muajit janar 2016, kategoria ekonomike - Rezerva, nën-programi - Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi transferohen në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere për kompenzimin e dëmeve në komuna si vijon:
 - Malishevë, në vlerë prej 26,000 euro, Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47013;
 - Suharekë, në vlerë prej 16,850 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47012;
 - Rahovec, në vlerë prej 2,380 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47011;
 - Lipjan, në vlerë prej 26,100 euro, Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47003;
 - Prizren, në vlerë prej 13,270 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47010;
 - Gjakovë, në vlerë prej 5,500 euro - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kod (470) nën-programi "Bujqësia" kod 47016;

- Shtime, në vlerë prej 16,520 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kodi (470) nën-programi "Zhvillim dhe inspektim bujqësor" kodi 47047;
 - Skenderaj, në vlerë prej 30,950 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kodi (470) nën-programi "Bujqësia" kodi 47023;
 - Ranillug, në vlerë prej 6,600 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kodi (470) nën-programi "Bujqësia" kodi 47037;
 - Mitrovicë, në vlerë prej 13,480 euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kodi (470) nën-programi "Bujqësia" kodi 47022;
 - Drenas, në vlerë prej 1,830euro, - Programi "Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural" kodi (470) nën-programi "Bujqësia" kodi 47001.
3. Mjetet nga pika e 2. e këtij vendimi, Komunitat i transferojnë tek përfituesit individual të dëmtuar nga vërshimet në bujqësi.
 4. Obligohen Komunitat e ndikuara, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/83

Datë: 06.04.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për kryetar dhe anëtarë të Komisionit Kosovar të Konkurrencës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Valon Prestreshi, kryetar;
 - 1.2. Ahmet Krasniqi, zëvendëskryetar;
 - 1.3. Fatime Haziri, anëtare;
 - 1.4. Mehmet Ballazhi, anëtar;
 - 1.5. Shaqir Morina, anëtar.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin, bashkë me biografite e të propozuarve, t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 09/79 i datës 15 mars 2016.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë